



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE
Drejtoria e Subjekteve Zgjedhore Mbikëqyrjes Financimit dhe Monitorimit
Sektori i Subjekteve Zgjedhore dhe Dekriminalizimit

Data	
Nr. Prot	

RELACION

VENDIMI

PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË PARTISË POLITIKE “LËVIZJA PËR
ZHVILLIM KOMBËTAR” PËR REGJISTRIMIN SI SUBJEKT ZGJEDHOR PËR
ZGJEDHJET PËR KUVEND TË DATËS 11 MAJ 2025

I. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.

Duke vlerësuar nga pikëpamja e objekti që trajton ky projektvendim, vlerësohet nga ana e ligjshmërisë se është në kompetencë të Komisionerit për ta shqyrtuar.

II. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Presidenti i Republikës me Dekretin nr. 399 datë 5.12.2024 ka caktuar datën 11 Maj 2025 për zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë.

Partia “Lëvizja për Zhvillim Kombëtar”, me Bashkë Kryetar, Z. Dashamir Shehu, dhe Z. Eqerem Spahiu, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvend që do të zhvillohen më datë 11 Maj 2025.

Bashkëlidhur kërkesës është paraqitur dokumentacioni vijues:

- a) Vërtetimi i lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Partive Politike, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, datë 24.02.2025, nëpërmjet të cilit vërtetohet se Partia “Lëvizja për Zhvillim Kombëtar”, me initiale “LZHK”, me Bashkë Kryetar Z. Dashamir Shehu, dhe Z. Eqerem Spahiu, rezulton e regjistruar në dokumentacionin e kësaj Zyre.
- b) Deklarata e angazhimit solem (Model KQZ-04-02)
- c) Deklarata për hapjen e llogarisë së posaçme bankare të partisë politike (Model KQZ-04-03)

Nga dokumentacioni si më sipër dhe nga përmbajtja e kërkesës rezulton se:

- a) Emri zyrtar i partisë është Partia “Lëvizja për Zhvillim Kombëtar” me shkronja nistore “LZHK”, me adresë Rruga "Andon Zako Çajupi", Tiranë;
- b) Bashkë Kryetar të partisë janë Z. Dashamir Shehu, dhe Z. Eqerem Spahiu, me adresë Rruga "Ali Visha", Pll.1, Ap.30, Tiranë.
- c) Financieri i partisë është Zj. Suzana Gina, me adresë “Rruga e Barrikadave", Pll.Nr.4, Tiranë;
- ç) Personi përgjegjës për komunikim me KQZ-në është Z. Rizaldo Vrenosi dhe Z.Fabian Topollari, me adresë Rruga "Sofokli Maliqari", Nd.7, Korçë;
- d) Specimeni i vulës së partisë është i specifikuar.

Kërkesa e paraqitur nga Partia “Lëvizja për Zhvillim Kombëtar”, respekton afatin kohor të parashikuar në pikën 1 të nenit 64, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Dokumentacioni bashkëshoqërues i kërkesës, i paraqitur nga Partia “Lëvizja për Zhvillim Kombëtar” është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenet 64, pika 2 dhe 92/2, pika 2, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Licela VELIU	-Drejtorja e Subjekteve Zgjedhore, Mbikëqyrjes Financimit dhe Monitorimit
Pavlina DOÇAJ	-Drejtorja e Ligjshmërisë
Majlinda ÇELMETA	-Sekretar i Përgjithshëm (në mungesë dhe me urdhër)